

PROGRAMI PËR KOLONOSKOPINË

KOLONOSKOPIA ËSHTË PLANIFIKUAR PËR:

DATA:

ORA:

PICOPREP® BUSTINA 1

DATA:

ORA:

PICOPREP® BUSTINA 2

DATA:

ORA:

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me ekzaminimin ose përgatitjen për ekzaminim, kontaktoni mjekun ose infermierin.

Një video udhëzuese që tregon mënyrën e përzierjes dhe të marrjes së "Picoprep" mund ta gjeni në **medicininstruktioner.se** (në suedisht).

Gjithashtu, në këtë faqe interneti mund të lexoni dhe të shkarkoni këshilla dhe receta për ushqime që treten lehtë, të cilat mund t'i konsumoni përpara ekzaminimit.



PICOPREP®

PICOPREP (Pikosulfat natriumi, oksid magnezi, acid citrik.)


Formulimi: Pluhur për solucion nga goja.

Indikimi: "Picoprep" indikohet për të rriturit, adoleshentët dhe fëmijët nga mosha një vjeç. Për përgatitjen e zorrëve përpara ekzaminimit me rreze X ose endoskopi. Për përgatitjen e zorrëve kur konsiderohet klinikisht e nevojshme përpara ndërhyrjes kirurgjikale. Kodi "ATC": A06AB58.

Madhësia e pakos: 2 bustina. Rx, F. SPC përditësuar më 8.8.2016

Për çmimin dhe informacione të mëtejshme, shihni www.fass.se.

Ndiqui gjithmonë udhëzimet e mjekut në recetën e dhënë. Përpara se të përdorni produktin, njihuni me fletudhëzuesin e pacientit, i cili përfshihet në pako.




Ferring Pharmaceuticals AB, Box 4041, SE-203 11 Malmö, Sweden. Tel: +46 40-691 69 00. info@ferring.se, www.ferring.se



PICOPREP®

UDHËZIMET PËR PËRGATITJEN E ZORRËVE PËRPARA KOLONOSKOPISË



Albanska / Shqip



UDHËZIMET PËR PËRGATITJEN E ZORRËVE PËRPARA KOLONOSKOPISË

Mjeku/infermieri ju ka këshilluar të bëni një kolonoskopi. Ky fletudhëzues ju tregon mënyrën më të mirë të përgatitjes për ekzaminimin në fjalë. Përpara se të përdorni produktin, njihuni me fletudhëzuesin e pacientit, i cili përfshihet në pako.



ÇFARË ËSHTË KOLONOSKOPIA?

Gjatë kolonoskopisë, mjeku/infermieri do të përdorë një aparat të gjatë dhe elastik ekzaminimi (me trashësinë e gishtit) të quajtur kolonoskop. Ai do të futet në anus, do të kalojë përgjatë gjithë rektumit dhe më pas në zorrën e trashë. Gjatë ekzaminimit mund t'ju jepet një bar qetësues. Personi që ekzaminohet zakonisht ndjen pak ose aspak dhimbje gjatë ekzaminimit. Kolonoskopi ka një dritë dhe kamerë për të ekzaminuar zorrën.



PSE KRYHET KOLONOSKOPIA?

Kolonoskopia kryhet për të ekzaminuar zorrët dhe për të zbuluar:

- **Inflamacionet (ënjtje dhe/ose skuqje)**
- **Polipet**
- **Sëmundje të tjera paratumorale ose tumore të mundshme**
- **Shkaqe të tjera të problemeve të zorrëve**

Gjithashtu, ekzaminimi i mundëson mjekut/infermierit që të heqë polipet para se të bëhen tumorale, si dhe të marrë mostra të vogla të membranës mukoze (biopsi) për analizë të mëtejshme.



ÇFARË ËSHTË THELBËSORE PËR KRYERJEN ME SUKSES TË KOLONOSKOPISË?

Një kolonoskopi e suksesshme fillon me zorrë të pastra dhe bosh. Në këtë mënyrë mjeku/infermieri mund t'i shohë dhe ekzaminojë zorrët në kushte ideale. Nëse ekzaminimi kryhet kur në zorrët tuaja ka ende fekale, do të jetë e vështirë të shikohet dhe vlerësohet prania e mundshme e polipeve ose tumorit në zorrën tuaj dhe mund t'ju duhet të riktheheni për ekzaminim në një datë të mëvonshme.

SA MË E PASTËR TË JETË ZORRA, AQ MË MIRË DO TË KRYHET KOLONOSKOPIA

Për t'u përgatitur për një kolonoskopi të suksesshme, zorra juaj duhet të jetë pastruar plotësisht. Ndiqni udhëzimet nga ofruesi i kujdesit shëndetësor. Pini shumë lëngje të pastra para se të filloni trajtimin dhe kryeni hapat përgatitore tërësisht në përputhje me udhëzimet.

PËRGATITJA PËR KOLONOSKOPINË

UDHËZIMET DIETIKE

Faza 1:

Nga 7 deri në 2 ditë para ekzaminimit duhet të konsumoni ushqim të lehtë për t'u tretur. Duhet të shmangni konsumin e drithërave, arrave dhe farave si dhe ushqimin e vështirë për t'u tretur, si kërpudhat, shpargun, qepët, specat, misrin dhe frutat ose perimet e pagatuara. **Gjatë 24 orëve para ekzaminimit** mos konsumoni ushqime të thata. Pini vetëm **lëngje të pastra. Shembuj të lëngjeve të pastra janë:** uji, pijet medicinale (jo të kuqe), lëngu i mollës, lëngu i mishit, pijet e pastra sportive dhe pijet e gazuara pa agjentë të fortë ngjyruar, birra me përqindje të ulët alkooli, solucionet e rihidratimit "Resorb" (nga farmacitë, pa recetë), pijet e pastra ushqyese, uji me mjaltë, kafeja dhe çaji pa qumësht. **Mos pini vetëm ujë!**



PICOPREP® është një bar me recetë, i cili përdoret për pastrimin e zorrëve. "Picoprep" ka shije portokalli. "Picoprep" do t'ju shkaktojë diarre për disa orë. Kjo shërben për pastrimin e zorrëve, duke bërë të mundur që mjeku/infermieri t'ju ekzaminojë dhe të shohë qartë zorrët tuaja.

MARRJA E PICOPREP®

Faza 2:

Tretni **bustinën e parë në 150 ml ujë të ftohtë dhe trazojeni për 2-3 minuta**. Pijeni këtë solucion 10-18 orë para kolonoskopisë, sipas kohës së udhëzuar me shkrim nga mjeku/infermieri.



Faza 3:

Pini të paktën **pesë gota 250 ml lëng të pastër** gjatë orëve në vijim.



Faza 4:

Përsërisni fazën 2 4-6 orë para kolonoskopisë, sipas kohës së udhëzuar me shkrim nga mjeku/infermieri. **Pini të paktën tre gota lëng të pastër** gjatë orëve në vijim. **Nëse keni etje, mund të vazhdoni të pini lëngje të pastra deri në dy orë përpara ekzaminimit.**



PAS KOLONOSKOPISË

Pas ekzaminimit, mjeku/infermieri do t'ju tregojë se çfarë ka vërejtur në zorrët tuaja. Nëse janë marrë mostra, rezultatet e tyre do t'i merrni më vonë.



KËRKOJINI NJË MIKU OSE NJË ANËTARI TË FAMILJES QË T'JU SHOQËROJË

Përpara ekzaminimit mund t'ju jepet një bar qetësues. Kjo do të thotë se nuk do të jeni në gjendje të drejtoni automjetin në mënyrë të sigurt dhe mund ta keni të vështirë të shkoni vetë në shtëpi. Prandaj duhet të vijë dikush për t'ju shoqëruar pas ekzaminimit. Pas ekzaminimit mund të ndjeni fryrje dhe lëvizje gazrash në stomak. Këto simptoma do të largohen pas disa orëve.



PAS KTHIMIT NË SHTËPI

Pushoni në pjesën e mbetur të ditës së ekzaminimit. Filloni të hani përsëri në racione të vogla, të cilat mund t'i shtoni gradualisht derisa të ktheheni në konsumin normal të ushqimit.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me ekzaminimin ose përgatitjen për ekzaminim, kontaktoni mjekun ose infermierin.

Një video udhëzuese që tregon mënyrën e përzierjes dhe të marrjes së "Picoprep" mund ta gjeni në [medicininstruktioner.se](https://www.picoprep.se) (në suedisht). Gjithashtu, në këtë faqe interneti mund të lexoni dhe të shkarkoni këshilla dhe receta për ushqime që treten lehtë, të cilat mund t'i konsumoni përpara ekzaminimit.

